



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2923 / Prot.

Tiranë, më , 26.11 2021

VENDIM

Nr. 49 ,datë 25.11. 2021

“PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË DISA NDRYSHIMEVE NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË FAKULTETIT TË EKONOMISË, TË UT-së”

Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma ç), të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 31, gërma dh), të Statutit të UT-së; në propozimin e Fakultetit të Ekonomisë, përcjellë me shkresën nr.918, datë 09.11.2021, në mbledhjen e datës 25.11.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,


VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht ndryshimet në strukturën organizative në 4(katër) njësitë bazë, të Fakultetit të Ekonomisë, në lidhje me numrin në plan të personelit akademik me kohë të plotë, konkretisht:

- Departamenti i Ekonomiksit: ishte 39 personel akademik, bëhet 38 personel akademik me kohë të plotë;
- Departamenti i Statistik-Informatikës së Zbatuar: ishte 31 personel akademik, bëhet 32 personel akademik me kohë të plotë;
- Departamenti i Menaxhimit, ishte 34 personel akademik, bëhet 33 personel akademik me kohë të plotë.
- Departamenti i Marketing-Turizmit: ishte 19 personel akademik, bëhet 20 personel akademik me kohë të plotë.

2. Vendimi t’i përcillet Bordit të Administrimit të UT-së.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha